

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.07.2023*

07.07.2023

Ora 12:39

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, për përsëritjen e zgjedhjeve, të datës 23 Korrik 2023”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Staf i KQZ: **Z.Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj**

• **Parti Politike:**

- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita atëherë, në seancë kemi në rend dite këto çështje, projektvendim që lidhet me miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Rrogozhinë të datës 23 Korrik 2023. Projektvendimin për materialet zgjedhore, dokumentacionin e punës që do të përdoret për këto zgjedhje. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Në nenin 98 të tij Kodi Zgjedhor përcakton se fleta e votimit prodhuar në blloqe me kundër fletë numri i serive të bllokut të kundërfletëve të votimit shënohet në dokumentin shoqëruar në bllokun e ambalazhuar sipas përcaktimeve të KQZ-së emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit sipas rendit të përcaktuar në mënyrë rastësore nga shorti jonë në KQZ. Duke qenë se në fletën e

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.07.2023*

votimit do të përdoret përmbatja e datës 14 Maj 2023 dhe shorti është hedhur më përpara për të identifikuar që nuk do të përdoret e njëjta fletë votimi por do të përdoret fletë tjetër votimi. Kemi bërë një shënim me këtë përmbajtje që zgjedhjet e përsëritura për kryetar të bashkisë të datës 23 Korrik 2023. Pjesa tjetër e fletës është e njëjtë më atë që është përdorur me datë 14 Maj. Bashkëlidhur keni për shqyrtim dhe miratim projektvendimin si dhe modelin e fletës së votimit që do të përdoret në datën 23 Korrik 2023, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Do të jetë e njëjta fletë votimi në përmbatje dhe në rradhitjen e kandidatëve dhe në elementët e tjerë shques të fletës, ngjyra apo mënyra e organizimit duke ndryshuar vetëm datën që do të jetë data 23 Korrik. Në rregull, dakord.

Vendimi nr. 683

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.07.2023*

07.07.2023

Ora 12:40

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për materialet zgjedhore dhe dokumentacionin e punës që do të përdoren në zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, të datës 23 korrik 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z.Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj**

- **Parti Politike:**

- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës me miratimin e materialeve dhe dokumentacionit.

Z. Y. Merkaj: Në referim të nenit 99 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja dërgon në selitë e KZAZ-ve, jo më vonë se 3 ditë, para datës së zgjedhjeve, materialet zgjedhore të ndara në kuti të veçanta për çdo QV. Projektvendimi i mësipërm është hartuar në kuadër të përgatitjeve, të zhvillimit dhe të administrimit të procesit zgjedhor, për zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë që do të zhvillohen në datën 23 Korrik, ka për qëllim të përcaktojë karakteristikat e materialeve zgjedhore që do të përdoren, si dhe dokumentacionin e punës të KZAZ-ve dhe të QV-ve. Materialet

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.07.2023*

zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, do të plotësojnë karakteristikat e përcaktuara në vendimin nr. 223, datë 7.12.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim”. Për vendosjen e materialeve zgjedhore do të përdoren kutitë e votimit, kapaku i të cilave do të jetë i vulosur me kodin e pestë nga KQZ dhe do të identifikohet me shenja dalluese si kuti të materialeve zgjedhore. KZAZ-të dhe QV-të do të përdorin dokumentacionin e punës të prodhuar për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, me shënimin me ngjyrë të kuqe me një vuulë tjetër e cila do të ketë përmbajtjen “Përsëritje e Zgjedhjeve për Kryetar Bashkie 23.7.2023”. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim.

Z. I. Celibashi: Miratojmë projektvendimin sipas draftit të propozuar. Çështje të tjera në rendin e ditës nuk kemi. Mirë faleminderit, seanca mbyllet ditë të mbarë.

Vendimi nr.684

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*

